



## KONKURS PËR PUNË

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), është duke kërkuar një kandidat të motivuar që t'i bashkohet ekipit tonë në pozitën:

### **Koordinator/e i/e Lartë për Zhvillim Profesional dhe Projekte**

Koordinator/e i/e Lartë për Zhvillim Profesional dhe Projekte do të jetë përgjegjës mbi mbarëvajtjen dhe zhvillimet profesionale në organizatë, duke përcjell zhvillimet e fundit të standardeve globale/ndërkombëtare dhe legjislationin vendor si dhe hartimin e projekt propozimeve dhe implementimin e projekteve. Bashkëpunon ngushtë me palët me interes duke ndihmuar kështu zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, ndërtimin e kapaciteteve në këtë lëmi për t'i ndihmuar zhvillimit ekonomik të vendit si dhe luan një rol aktiv në vetëdijesimin e palëve me interes mbi rëndësinë e profesionit.

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë**

- Asiston në çështjet profesionale nga rregullatorët vendor dhe ndërkombëtar;
- Bashkëpunon me Komisionet e ShKÇAK dhe përkrah punën e tyre (në Standarde Profesionale) dhe në zhvillimin e metodave më të përshtatshme për programin e certifikimit;
- Bashkëpunon me palët me interes për të siguruar një sistem efikas dhe efektiv të raportimit financiar në Kosovë;
- Asiston në përgatitjen e strategjive dhe planeve të punës së ShKÇAK për Edukim profesional;
- Asiston për zhvillimin e procesit të programit të edukimit të ShKÇAK si dhe në krijimin e programeve të reja të edukimit profesional;
- Asiston për implementimin e procedurave dhe rregulloreve për Edukim profesional, si dhe të gjitha kërkesat tjera të nevojshme gjatë procesit të implementimit;
- Asiston për zhvillimin dhe azhurnimin e materialeve të trajnimit dhe materialeve tjera;
- Harton propozime të detajuara që përmbajnë objektivat e projektit, metodologjinë e zbatimit, buxhetin e detajuar, dhe parashikimin që projekti do të sjellë;
- Zhvillon strukturën e përgjithshme të projektit, duke përfshirë fazat kryesore, detyrat dhe afatet kohore. Përgatit gjithashtu planin e burimeve të nevojshme për realizimin e projektit;
- Bashkëpunon me departamentet tjera në realizimin e strategjisë, planit të punës dhe buxhetit të ShKÇAK;
- Raporton te Drejtori Ekzekutiv dhe/ose Zëvendës Drejtori mbi realizimin e objektivave dhe zhvillimin e aktiviteteve dhe punëve të paracaktuara;
- Kryen detyra tjera siç mund të kërkojnë në pajtim me natyrën e punës.

#### **Kualifikimet dhe kompetencat:**

- Diplomë universitare;
- Përvojë të punës në profesion, hulumtime dhe projekte zhvillimore;
- Aftësi të mira komunikuese dhe punës në ekip;
- Njohja e gjuhës angleze është e domosdoshme;
- Njohuri të avancuar në MS Office;
- Kandidatët kërkojnë të kenë vetëiniciativë për zhvillim të mëtutjeshëm të planprogramit dhe proceseve brenda organizatës.



*Referencat janë të domosdoshme dhe duhet të dërgohen me CV.*

Dorëzoni CV-në tuaj në E-mail adresën: **hr@scaak.org**

Për pozitën: **Koordinator/e i/e Lartë për Zhvillim Profesional dhe Projekte**

**CV-të i pranojmë deri me 22.9.2026**

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.